



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 2345 / prot.

Pogradec, më 26 06 2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Z. MANJOLA KAMOLLI
KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

" PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR NGRITJE FIDANISHTE, TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 20400 M2 (NJEZET MIJË E KATERQIND) M2."

Me respekt,

KRYETARI
Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (Dy)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (Dy)

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 4(Kater)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI



Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____ 2025

PROJEKT-VENDIM
Nr. ____, DATË ____ / ____ /2025

PER MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR NGRITJE FIDANIShte, TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 20400 M2 (NJEZET MIJË E KATERQIND) M2.

1. Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore ", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.816, datë 04.06.2008 "Për miratimin e listes së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore pyje e kullota në Komunën Çërravë, të Qarkut të Korçës", i ndryshuar me VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr.433, datë 08.06.2016, të Keshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronesi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish – Komunave /Bashkive", si dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave, Udhëzimi nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" dhe sipas tarifave të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 " Per përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtarie ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ", me propozim të Kryetarit të Bashkisë,, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

2. Të miratojë në parim dhënien me qira, për shesh për ngritje fidanishte, për pasurinë e ndodhur në fshatin Grabovice, Njësia Administrative Çërravë, Bashkia Pogradec, me të dhënat si më poshtë:

Nr	Z.K	Pasuria	Vëndodhja	Siperf në m2	Objekti kërkeses
1	1832	272	Grabovicë, Çërravë	20400	Ngritje fidanishte

3. Afati i dhenies me qera të jete deri në 10 vite, me të drejte ripertëritje, sipas periudhes të përcaktuar në projektin teknik, të hartuar nga kërkuesit në konkurim.
4. Në referim të bazës ligjore të sipercituar, ky proces të kryhet sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" dhe sipas tarifave të

përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 " Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtarive ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore "

5. Tarifat për dhënien me qera të kesaj pasuri, të aplikohen sipas pikes "1", te shtojces nr 1 të Vendimit Nr. 559, datë 29.07.2022 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien ne Shfrytezim/ perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.
6. Ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Pogradec për ndjekjen e procedurave ligjore dhe për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT DHE ADMINISTRIMIT TOKES BUJQESORE NE NJESITE ADMINISTRATIVE
SEKTORI TRAJTIMIT TITUJVE PRONESISE DHE SHPRONESIMEVE

Nr. 2348 / Prot.

Pogradec, më 24.06.2025

RELACION
PËR

MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR NGRITJE FIDANIShte, TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 20400 M2 (NJEZET MIJË E KATERQIND) M2.

INDERUAR KRYETARE KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Bashkia Pogradec në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, referuar pikës 2 të nenit 27 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ndër të cilat është edhe Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme, pyll,etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, posacerisht të kaluara në pronësi të saj me VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime ne vendimin nr.433, date 08.06.2016, të Keshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish – Komunave /Bashkive", Me transferimin e pronave në administrimin vendor, menaxhimi i aseteve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin.

Për sa më sipër, Sektori i Trajtimit të Titujve të Pronësisë dhe Shpronësimeve, Bashkia Pogradec, ka marrë evidentuar pronen me nr 272 Zk 1832 qe mund te jete nje prone qe mund te zhvillohet nga individe te ndryshem per qellimin e cituar me lart, për vete pozicionimin dhe vendosjen e kesaj prone mabsi eshte larg nga qendrat e banuar dhe pa ndikime ne mjedis.

Nga analiza dhe interesimi i disa individeve dhe pozicionin e pasurise propozojme dhenien me qera te siperfaqes prej 2.04 ha siperfaqe e cila sipas llojit te qeverisjes se pyjeve sipas planit te mbareshtimit te ish komunes Cerrave eshte kullote ne vendin e quajtur Grabovice si dhe nga verifikimi ne vend dolen me keto konkluzione:

Sipas VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime ne vendimin nr.433, date 08.06.2016, të Keshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish – Komunave /Bashkive", pasuria 272 Zona kadastrale 1832, që është pjesë e ngastres 2 te Ekonomise Kulosore Pretushe -Lin kalon ne pronesi Bashkise Pogradec, e cila duke ndjekur te gjitha procedurat ligjore eshte paisur me dokumentacionin perkates te pronesise, bashkangjitur ketij relacioni.

Per sa me siper, u monitorua pasuria nr. 272 kullote qe kerkohet te miratohet ne parim fillimi i procedurave per dhenie me qira, me siperfaqe 20400 m2, me të dhënat si më poshtëme;

Nr	Z.K	Nr Pasur	Vëndodhja	Lloji Pasurisë	Sipr në m2	Perdorimi sipas plan biznesit	Fakti ne momentin e monitorimit
1	1832	272	Grabovice	Kullote	20400	Fidanishte	Kullote

Siperfaqia e kerkuar ndodhet , ne kufirin ndermjet Fshatrave Grabovice dhe Pretushe ne nje lagesi te konsiderueshme nga qendrat e banuara, dhe tradicionalisht ka qene pjese e fshatit Grabovice.

Ne referim te bazes ligjore te sipercituar, ky proces te kryhet sipas percaktimeve te Udhëzimi nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" dhe sipas tarifave të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 " Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtarive ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore "

Tarifat për dhënien në përdorim/qera të ketyre pasurive, të aplikohen sipas pikes "1", te shtojces nr 1 të Vendimit Nr. 559, datë 29.07.2022 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien ne Shfrytezim/ perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.

Perfundimisht, per sa me siper, Në zbatim të nenit 54, shkronja "e" të Ligjit Nr. 139, datë 17.12 2014 "Për veteqeverisjen vendore", citohet se: *"Këshilli bashkiak, ndër të tjera, e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve". Mbas edhe konsultimi publik me pjesemarrjen e keshilltareve eshte realizuar, ne datë 16/06/2025 ora 10.00 dhe nuk ka pasur kontestime apo problematika per kete pasuri dhe jane dakorteluar per vazhdimin e procedurave per dhenien me qira.*

Duke pasur besim te plote, ju ftojme te miratoni projekt vendimin e paraqitur.
Ju Faleminderit !

Ju faleminderit!

Konceptoi: Nexhmi TORRA




Konfirmoi Paskalino ZIKO

Miratoi Dritan BABASULI

**KRYETAR
ILIR XHAKOLLI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 05/06/2025 **Ora :** 12 :00

Vendi: Fshati Cërravë

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 18 persona të pranishëm

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

Për miratimin e listës së fondit kullososr, që mund të jepen me qera, për kullotje e kositje bari, me sipërfaqe prej 1512,75 ha, në Ekonomitë Kullososre: “Golik-Kalivac”, “Vërri- Debrovë”, “ Petrushë- Lin ”, “Guri Top-Gjëmth”, “Dunicë -Llëngë” dhe “Nicë –Valamarë”, dhe kontratës tip.

Pjesëmarrës :

Vjollca Pllaha (Këshilltar)

Klajdi Gjona (Këshilltar)

Marjeta Biba (Këshilltare)

Arbër Male (Këshilltar)

Jona Bojko (Sekretare e Këshillit)

Arjan Minga (Specialist I Bashkisë)

Olger Ibi (Administrator I Njesisë AdministrativeCërravë)

Jona Bojko (Sekretare e Këshillit) bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues.
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik.
- Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit.
- Jep informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve.

Arjan Minga: (Përgjegjës, sektori I kullotave): Projekt- Vendimi I hartuar nga sektori I kullotave u paraqit në mbledhjen e këshillit I cili sipas ligjit duhet të kalojë në konsultim publik për të pyetur banorët. Afati I dhënies me qera është deri në tre vjet, në përputhje të njësisë mbajtëse të kullotës. Njësia Administrative Cërravë përfshin ekonominë kullosore Petrushe- Lin. Tarifa që do paguhet është 50 lekë / krer për dhen dhe 80 lekë për krer për dhi. Bëhet fjalë për kullotat që janë larg fshatit. Disa toka që janë afër fshatit nuk janë pjesë e Bshkisë po janë pjesë e zonave të mbrojtura.

Marjeta Biba: Mqs është në zonën tuaj jeni jut ë parët që do tju jepet prioritet .



Lytfi Dikellari (Kryeplak I fshatit Nizhavec) : Tokat në fshatin Nizhavec I ka puna një person tjetër që kultivon sherebelin ka 10 vjet.

Agim Hajrulla: (fshati Lumas) Në fshatin Lumas janë 3 tufa me bagëti të imeta. Te vijë një person tjetër dhe ti marrë duket sikur ju futet në hak banorëve.

Sekretare e Këshillit

Jona BOJKO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 05/06/2025 **Ora :** 10 :00

Vendi: Fshati Dardhas

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 14 persona të pranishëm

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

Për miratimin e listës së fondit kullosor, që mund të jepen me qera, për kullotje e kositje bari, me sipërfaqe prej 1512,75 ha, në Ekonomitë Kullosore: “Golik-Kalivac”, “Vërri- Debrovë”, “ Petrushë- Lin ”, “Guri Top-Gjëmth”, “Dunicë -Llëngë” dhe “Nicë –Valamarë”, dhe kontratës tip.

Pjesëmarrës :

Vjollca Pllaha (Këshilltar)

Klajdi Gjona (Këshilltar)

Marjeta Biba (Këshilltare)

Jona Bojko (Sekretare e Këshillit)

Arjan Minga (Specialist I Bashkisë)

Erton Mucka (Administrator I Njesisë Administrative Dardhas)

Jona Bojko (Sekretare e Këshillit) bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me :

-Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues.

- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik.
- Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit.
- Jep informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve.

Erton Mucka Specialisti I Bashkisë të shpjegojë më mirë pozicionin ku ndodhen këto toka që banorët të jenë më të qartë në lidhje me çështjen që është për tu diskutuar.

Arjan Minga: (Përgjegjës, sektori I kullotave): Projekt- Vendimi I hartuar nga sektori I kullotave u paraqit në mbledhjen e këshillit I cili sipas ligjit duhet të kalojë në konsultim publik për të pyetur banorët. Bëhet fjalë për kullotat që janë larg fshatit. Ekonomitë që zë Njesia Administrative Dardhas janë Ekonomia Nicë-Valamarë, Petrushë-Lin. Këto kullota do të jepen me qira për kullotje bagëtish dhe kositje bari. Afati I dhënies me qera do të jenë nga 1-3 vjet. Janë 6 parcela që përfshihen në këtë projekt- vendim. Ngastrat e tjera janë te vendi që quhet Guri I Nikës dhe janë në administrim të Zonave të Mbrojtura. Nuk janë futur kullotat rreth Gurit të Kamjes sepse ato do të administrohen nga fshati.

Marjeta Biba: Të drejtën parësore për ti marrë këto toka me qera e keni ju.

Fatos Hamolli: Duhet të na japë shteti subvencionim.

Erton Mucka (Administrator): Ka afër fshatit Osnat, toka që përfshihen në këtë PV? Sepse atje ka 3-4 tufa dhe do të përdoren më shumë nga banorët e zonës.

Arjan Minga (Specialist I Bashkisë): Është në ligj që prioritetin e kanë fillimisht banorët e zonës për ti marrë me qera.

Florjan Manxhari: Të informojmë banorët që nqs ka toka në fshatin Osnat, ata që janë të interesuar të aplikojnë.

Fatos Hamolli: Ne kemi lënë tokat tona pa I punuar.

Erton Mucka : Unë e di që cdo vit paguhet taksa e kullotave . Banorët që kanë kullota pretendojnë se e kanë paguar taksën.



Arjan Minga: Në zonën tuaj janë reth 30 tufa dhe vetëm dy janë pagues të rregullt.

Erton Mucka : Ata që I paguajnë kanë pretendime se vijnë të tjerë dhe futen në parcelat e tyre. Nqs tufa që vjen nga Bashkia Maliq, tarifa paguhet në Bahkinë Maliq, pse duhet të futet tek zona jonë? Ndaj ne nqs I bindim që ti pafuajnë tarifat , do I mbrojmë që ms futen tufa të tjera.

Sekretare e Këshillit

Jona BOJKO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 09.06/2025 **Ora :** 12 :00

Vendi: Fshati Velcan

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 12 persona të pranishëm

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

Për miratimin e listës së fondit kullosor, që mund të jepen me qera, për kullotje e kositje bari, me sipërfaqe prej 1512,75 ha, në Ekonomitë Kullosore: “Golik-Kalivac”, “Vërri- Debrovë”, “ Petrushë- Lin ”, “Guri Top-Gjëmth”, “Dunicë -Llëngë” dhe “Nicë –Valamarë”, dhe kontratës tip.

Pjesëmarrës :

Besnik Xhyra (Këshilltar)

Vjollca Pllaha (Këshilltar)

Arjan Minga (Specialist I Bashkisë)

Ilia Mani (Administrator I Njesisë Administrative Velcan)

Ilia Mani ((Administrator I Njesisë Administrative Velcan) bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues.
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik.
- Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit.

-Jep informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.

-Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.

-Ju dha fjalën pjesëmarrësve.

Arjan Minga: (Përgjegjës, sektori I kullotave): Projekt- Vendimi I hartuar nga sektori I kullotave u paraqit në mbledhjen e këshillit I cili sipas ligjit duhet të kalojë në konsultim publik për të pyetur banorët. Bëhet fjalë për kullotat që janë larg fshatit. Ekonomitë që zë Njesia Administrative Trebinjë janë Ekonomia Nicë- Valamarë, Golik- Kalivac, Nicë – Valamar. . Këto kullota do të jepen me qira për kullotje bagëtish dhe kositje bari. Afati I dhënies me qera do të jenë nga 1-3 vjet.

Shpetim Lato (Kryeplak I fshatit Velcan: Jemi dakort sepse në këtë mënyrë të gjithë individët që kanë kullota e dinë vendin ku duhet të kullosin..

Flamur Demollari(Kryeplak I fshatit Jolle): Ne jemi dakort qe keto toka te jepen perderisa jane toka shtet dhe nuk I ka njeri ,aq me teper qe nuk shrytezohen nga fshataret.

Shkelqim Cela 9Buzaishte):Mendojmë që parësi duhet të kenë banorët e zones,nese nuk I do askush nga fshataret le ti marin te tjeret.



Arjan Minga: (Përgjegjës, sektori I kullotave):Patjeter.

Ilia Mani ((Administrator I Njesisë Administrative Velcan) :Ju falenderojme qe ishit te pranishem.

Sekretare e Këshillit

Jona BOJKO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 09.06/2025 **Ora :** 12 :00

Vendi: Fshati Velcan

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 12 persona të pranishëm

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

Për miratimin e listës së fondit kullosor, që mund të jepen me qera, për kullotje e kositje bari, me sipërfaqe prej 1512,75 ha, në Ekonomitë Kullosore: “Golik-Kalivac”, “Vërri- Debrovë”, “ Petrushë- Lin ”, “Guri Top-Gjëmth”, “Dunicë -Llëngë” dhe “Nicë –Valamarë”, dhe kontratës tip.

Pjesëmarrës :

Besnik Xhyra (Këshilltar)

Vjollca Pllaha (Këshilltar)

Arjan Minga (Specialist I Bashkisë)

Ilia Mani (Administrator I Njesisë Administrative Velcan)

Ilia Mani ((Administrator I Njesisë Administrative Velcan) bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues.
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik.
- Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit.

-Jep informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.

-Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.

-Ju dha fjalën pjesëmarrësve.

Arjan Minga: (Përgjegjës, sektori I kullotave): Projekt- Vendimi I hartuar nga sektori I kullotave u paraqit në mbledhjen e këshillit I cili sipas ligjit duhet të kalojë në konsultim publik për të pyetur banorët. Bëhet fjalë për kullotat që janë larg fshatit. Ekonomitë që zë Njesia Administrative Trebinjë janë Ekonomia Nicë- Valamarë, Golik- Kalivac, Nicë – Valamar. . Këto kullota do të jepen me qira për kullotje bagëtish dhe kositje bari. Afati I dhënies me qera do të jenë nga 1-3 vjet.

Shpetim Lato (Kryeplak I fshatit Velcan: Jemi dakort qe keto toka te jepen me qera, sepse në këtë mënyrë të gjithë individët që kanë kullota e dinë vendin ku duhet të kullosin..

Flamur Demollari(Kryeplak I fshatit Jolle): Ne jemi dakort qe keto toka te jepen perderisa jane toka shtet dhe nuk I ka njeri ,aq me teper qe nuk shrytezohen nga fshataret.

Shkelqim Cela 9Buzaishte):Mendojmë që parësi duhet të kenë banorët e zones,nese nuk I do askush nga fshataret le ti marin te tjeret.

Bujar Elezi:Per ne nuk ka asnje problem perderisa askush nga ne nuk cenohet.

Arjan Minga: (Përgjegjës, sektori I kullotave):Patjeter.

Ilia Mani ((Administrator I Njesisë Administrative Velcan) :Ju falenderojme qe ishit te pranishem.

Sekretare e Këshillit

Jona BOJKO